



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Logistics Plus L.L.C." të datës 16.05.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 10.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e e-kiosqeve dhe furnizimi me pjese rezervë dhe toner për printer-RITENDER 2" me nr. të prokurimit 616-23-4575-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Logistics Plus L.L.C." e datës 16.05.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 10.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e e-kiosqeve dhe furnizimi me pjese rezervë dhe toner për printer-RITENDER 2" me nr. të prokurimit 616-23-4575-2-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Logistics Plus L.L.C." si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Logistics Plus L.L.C." (tutje "parashtruesi") me datë 16.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 10.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e e-kiosqeve dhe furnizimi me pjese rezervë dhe toner për printer-RITENDER 2" me nr. të prokurimit 616-23-4575-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) – “Diploma e kërkuar “Master Inxhinier te Telekomunikacioni Elektronik” duke mos mundësuar diploma ekuivalente, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik”.

Pretendimi i dytë (II) – “Certifikimi i kërkuar për “CCNA Routing & Switching” fare nuk ka te beje me qëllimin e kontratës pasi që ky certifikim, dëshmon aftësinë në fushën e rrjetit, teknologjitë e ndërrimit LAN, teknologjitë e ndërrimit IP, teknologjitë WAN, shërbimet e infrastrukturës dhe siguria e infrastrukturës”.

Pretendimi i tretë (III) – “Certifikimi i kërkuar për “VMWare Data Center Virtualization”, fare nuk ka te beje me qëllimin e kontratës pasi që ky certifikim, dëshmon aftësinë në fushën e virtualizimit të qendrës së të dhënave”.

Pretendimi i katërt (IV) – “OE duhet te jete i qertifikuar me ISO Standardet 27001, 9001, 14000, Certifikata ISO 14000, ka te beje me menaxhimin në përgjegjësitë mjedisore, ky certifikim vetëm e redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik sepse fare nuk ka te beje me fushëveprimin e kontratës”.

Pretendimi i pestë (V) – “Periudha e implementimit te Aplikacionit është 30-40 ditë - periudha e implementimit është përcaktuar, por nuk tregon se qa duhet te implementohet”.

Pretendimi i gjashtë (VI) – “Instalimi nëpër e-kiosqet është 14-20 ditë - periudha e instalimit neper e-kiosqet për 14-20 dite, pa treguar se qa është menduar te instalohet”.

Pretendimi i shtatë (VII) – “Aplikacioni së bashku me kodin burimor (Source Code) të jenë pronë e Komunës. 3.1. Autoriteti Kontraktues, kërkon që kodi burimor (Source Code) të jenë pronë e Komunës, por nuk tregon se për cilin sistem duhet të dorëzohet Source Code, pasi që në kërkesat e dosjes të tenderit, kërkohet mirëmbajta e një sistemit për te cilin nuk kanë treguar se qa përmban, në cfar teknologjie është i nderuar sistemi, a e posedon kodin burimor Autoriteti Kontraktues na kontrata paraprake te negociuara me një OE”.

Pretendimi i tetë (VIII) – “Autoriteti Kontraktues, ka shkelur nenin Neni 52 LPP, duke vendosur kërkesa administrative tek kërkesat teknike”.

Pretendimi i nëntë (IX) – “Autoriteti Kontraktues, ka shkelur nenin neni 21.7 të ROPP sepse ka publikuar informata sqaruese dhe nuk ka përdorur formularin standard B54”.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28 dhe 52 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 23.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë i dt. 10.05.2023.
- Dosja e tenderit e dt. 10.05.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara dt. 18.05.2023.
- Përgjigja e njesisë kërkuese lidhur me pretendimet e parashtruesit e dt. 19.05.2023.

Lidhur me pretendimin e parë (I) zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime shtesë sa i përket pretendimit të parashtruesit. Me këtë rast njësia kërkuese është përgjigjur se “*Diploma Master te Telekomunikacionit ose Elektronik eshte kerkuar per shkak te mirembajtjes se pajisjeve te e-kiosqeve dhe kuptimit te funksionalizimit elektrik*”. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë sqarim pse një kriter i tillë është diskriminues apo favorizues duke mos parashtruar asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime shtesë sa i përket pretendimit të parashtruesit. Me këtë rast njësia kërkuese është përgjigjur se “*Certifikata CCNA Routing & Switching eshte kerkuar pikerisht per mirembajtje te sigurise se infrstruktures perfaktin qe sherbimi i kryer permбан informata personale*”. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë sqarim pse një kriter i tillë është diskriminues apo favorizues duke mos parashtruar asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë (III) zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime shtesë sa i përket pretendimit të parashtruesit. Me këtë rast njësia kërkuese është përgjigjur se “*Vmware Data Centre Virtualization eshte kerkuar pikerisht per mirembajtje te pikave te virtualizara*”. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë sqarim pse një kriter i tillë është diskriminues apo favorizues duke mos parashtruar asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e katërt (IV) dhe të pestë (V) zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime shtesë sa i përket pretendimit të parashtruesit. Me këtë rast njësia kërkuese është përgjigjur se “*Aplikacioni duhet të ndërtohet (zhvillohet) nga fillimi hap pas hapi në mënyrë profesionale nga kompani profesionale pasi që në të kaluarën kemi pasur probleme me funksionalizime të aplikacionit qysh në vitin e kaluar pasi që kompania e më parshme as që e kishte ide se qfarë ndërlihdje duhet të bëhet në mes ASHI-së dhe e-kioskut*”. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur sqarim të qëndrueshëm, argument apo dëshmi të bazuar për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e gjashtë (VI) zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime shtesë sa i përket pretendimit të parashtruesit. Me këtë rast njësia kërkuese është përgjigjur se *"Pasi që të zhvillohet (ndërtohet) duhemi patjeter me u instalua nëpër secilin aparat aplikacioni ku duhet të ndërlihet secila ekiosk me (Government Gateway) ku secili e kiosk ka nga një ID të ndryshme dhe për këtë duhet kohë deri sa të përfundon"*. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë sqarim të qëndrueshëm, argument apo dëshmi të bazuar për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e shtatë (VII) zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime shtesë sa i përket pretendimit të parashtruesit. Me këtë rast njësia kërkuese është përgjigjur se *"Aplikacioni kodi burimor (Source Code) patjeter duhet të jet pjesë e Komunës për arsye të së kaluarës kemi pasur mjaft probleme me përgjegjës O.E për arsye të neglizhimit të punës në kohë të caktuar ku siç e dim po thuhet 40% e popullatës së teritorit të Kosovës shërbehën në kryeqytet me dokumente personale dhe ata nuk e meritojnë një bllokim, sabotim, apo neglizhencë të një O.E, siç ka ndodhur në të kaluarën"*. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë sqarim të qëndrueshëm, argument apo dëshmi të bazuar për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tetë (VIII) është gjetur se parashtruesi nuk ka sqaruar se cilat kërkesa administrative qenkan vendosur te kërkesat teknike dhe përse ky veprim përbën shkelje të nenit 52 të LPP sikurse pretendon parashtruesi. Për të qenë një pretendim i shqyrtueshëm ai duhet të jetë i formuluar në mënyrë të saktë jo vetëm gjuhësisht por edhe të përmbajë sqarimet e nevojshme duke u bazuar në argumentet mbështetëse. Në rastin konkret parashtruesi vetëm ka thënë se *"Autoriteti Kontraktues, ka shkelur nenin Neni 52 LPP, duke vendosur kërkesa administrative tek kërkesat teknike"*. Prandaj ky pretendim i parashtruesit është pretendim i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin e nëntë (IX) është gjetur se RRUOPP (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik) për të cilin parashtruesi pretendon se është shkelur neni 21.7, nuk është fare në fuqi pasi që i njëjti është shfuqizuar nga RRPP. Prandaj edhe ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2 të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.05.2023


Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.